Republika
P. 13572 21/12

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURES DHE ZBATIMIT TE PROJEKTEVE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421211; Fax 033 421201; www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al

Nr.2929 prot

Vlorë 05 .11.2012

Qendra "Res Publika"
Rruga "Bulevardi Zhan d'ark"
Pallati nr.13
Tirane

Lenda : Kthim pergjigje

Ne pergjigje te kerkeses suaj ardhur ne Bashkine Vlore ne date 23/10/2012 "Kerkese per informacion dhe venie ne dispozicion e dokumentacionit", para se gjithash ju shprehim mirekuptimin, por edhe interesimin tone per te trajtuar nje problem kaq me rendesi, te trajtimit te familjeve qe jetojne ne banesat e ish pronareve dhe lirimit te banesave te tyre.
Ne qytetin e Vlores kane fituar statusin e te pastrehut te grupit te pare (familje qe jetojne ne banese ish prone private) miratuar me Vendim te Keshillit Bashkiak, 408 familje. Nje numer i vogel familjesh per aresye qe nuk mund te percaktohen nuk e kane fituar nje status te tille, edhe pse kane jetuar dhe vazhdojne te jetojne ne banesat e ish pronareve.
Jane trajtuar gjithsej me banese apo kredi per te blere banese ne treg te lire, 100 familje.
20 familje banesat e te cilave rezultojne ne gjendje krejtesisht te amortizuar apo rrezik shembje, trajtohen me bonus qiraje me fondet e Bashkise Vlore
Aktualisht rezultojne te patrajtuar me strehim, 308 familje.
Lidhur me kerkesen tuaj, nisur nga Akti Normativ i KM Nr.3 date 01.08.2012, sqarojme :

1. Bashkia Vlore nuk ka perfituar asnje fond te posaçem nga buxheti i shtetit ne lidhje me efektet e zbatimit te aktit normativ ne fjale.
2. Edhe pse eshte hartuar programi 10-vjeçar per strehimin social ne qytetin e Vlores, ku evidentohen numri i strehim kerkuesve te gjithe kategorive, nevojat dhe fondet per plotesimin e tyre, Bashkia Vlore nuk ka ndertuar apo planifikuar te ndertoje banesa, per shkak;
   -te mungeses se fondeve te mjaftueshme
   -te mos regjistrimit te pronave te Bashkise
3. Pra, aktualisht nuk kemi banesa sociale ne dispozicion te te pastreheve te kategorise ne banesat ish prone private apo te te pastreheve ne pergjithesi.
   Numri i pergjithshem i qytetareve qe kane aplikuar dhe plotesojne kushtet per tu trajtuar me banesa sociale me qira eshte 350, numri i qytetareve qe kane aplikuar per tu trajtuar me banese me kosto te ulet edhe nepermjet kredive hipotekore, eshte rreth 750.
   Sa me siper, deshirojme tu informojme se Bashkia e Vlores nuk ka perfituar nga projekti i i ndertimit te banesave sociale, sipas marreveshjes se nenshkruar na Qeveria Shqiptare dhe Banka per Zhvillim e Keshillit te Europes CEB, por kerkesa per tu perfshire ne nje faze dyte te ketij projekti nepermjet MPP&T, nuk ka gjetur zbatim.
   Duke ju falenderuar per mirekuptimin

Shpetim GJIKA
KRYETAR